

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK

NJOFTIM

Ju lutemi, gjeni më poshtë njoftimin e mbledhjes së radhës së Këshillit Bashkiak të Tiranës, e cila do të zhvillohet ditën e **Martë datë 30 Prill 2024, ora 16:30**, në sallën e Këshillit Bashkiak.

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Në zbatim të nenit 53 të ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ju përcjell për shqyrtim dhe diskutim, pikat e rendit të ditës, si më poshtë:

1. **Projektvendim “Për miratimin e familjeve aplikuese që përfitojnë nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind, nga fondi i kushtëzuar dhe nga buxheti i Bashkisë Tiranë, për periudhën 1- 31 mars 2024”.**
2. **Projektvendim “Për miratimin e bonusit të qirasë të individëve/familjeve, pasuritë e të cilëve preken nga zbatimi i projektit të segmentit rrugor “Unaza e Madhe e Tiranës, Sheshi Shqiponja- Bulevardi i Ri, Shkozë””.**
3. **Projektvendim “Për dhënien e ndihmës financiare për 26 (njëzet e gjashtë) familje që kanë pësuar dëme ndërtimore dhe në orendi/pajisje elektroshtëpiake si pasojë e zjarrit dhe përmbytjeve”.**
4. **Projektvendimin “Për dhënien e titullit vendor të nderit, “Qytetar Nderi”, z.Ali Ahmeti”.**
5. **Projektvendimin “Për emërtimin e disa rrugëve në territorin e Bashkisë Tiranë”.**
6. **Projektvendimin “Për një ndryshim në vendimin nr. 78, datë 05.07.2023 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Këshillit Bashkiak”.**
7. **Projektvendimin “Mbi miratimin e shpenzimeve për aktivitetin e Këshillit Bashkiak Tiranë në Korçë, datë 24-26 maj 2024”.**
8. **Projektvendimin “Për miratimin e dhënies në përdorim pa kundërshpërblim të ambientit të Ndërmarrjes Oficina e Automjeteve të Transportit ndaj organizatës “Nisma për ndryshim shoqëror- Arsis”.**
9. **Projektvendimin “Për shpërblimin financiar të klubit të futbollit "Partizani" sh.a, si rezultat i fitimit të vendit të parë, në Kampionatin Kombëtar të Kategorisë Superiore, për sezonin 2022-2023”.**
10. **Projektvendimin “Për miratimin e listave të përfituesve të programeve të procesit të rindërtimit”.**

Ju faleminderit,

Romina Kuko

Kryetare e Këshillit Bashkiak

MBLEDHJET E KOMISIONEVE

Komisioni i Kulturës, Turizmit dhe Trashëgimisë Kulturore, do të shqyrtojë pikat **4,5** dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e hënë, datë **29 prill, ora 11:00**.

Komisioni i Financave dhe Buxhetit, do të shqyrtojë pikat **1,2,3,7,9,10** dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e hënë, datë **29 prill, ora 12:00**.

Komisioni i Çështjeve Ligjore dhe Drejtësisë Sociale, do të shqyrtojë pikat **2,6,7,8,9,10** dhe do të mbledhet në sallën e Këshillit Bashkiak, ditën e hënë, datë **29 prill, ora 13:30**.